



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 535/10 prot.

Datë 01.04.2026

V E N D I M
Nr. 453/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.04.2026 shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 400/2026, datë 17.03.2026 për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar –”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6., Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë. Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 17.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 400/2026, ku vendosi:

“[....]”

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [....]”

I.2. Me shkresën nr. 1228/1 prot., datë 27.03.2026 me objekt “Njoftim për zbatimin e Vendimit nr.400/2026, Nr.535/5 prot të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën nr. 535/7 prot., datë 30.03.2026, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë njofton se ka zbatuar vendimin Nr.400/2026, datë 17.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

II Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1228/1 prot., datë 27.03.2026 me objekt “Njoftim për zbatimin e Vendimit nr.400/2026, Nr.535/5 prot të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën nr. 535/7 prot., datë 30.03.2026, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë njofton se ka zbatuar vendimin Nr.400/2026, datë 17.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se shtojca është publikuar në SPE.

Nga verifikimet në shtojcën e dërguar nga autoriteti kontraktor dhe publikuar në SPE, konstatohet se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 400/2026, datë 17.03.2026.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë e ka zbatuar vendimin vendimin Nr. 400/2026, datë 17.03.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

